

LIBERALIZIMI I VIZAVE ME KOSOVËN¹

UDHËRRËFYES

I. HYRJE – KORNIZA E PËRGJITHSHME

A. Si pjesë e agjendës së Selanikut, të deklaruar më 16 qershor 2003,² Bashkimi Evropian dha një zotim politik që të liberalizojë regjimin afatshkurtër të vizave për Ballkanin Perëndimor. Më 10 dhjetor 2007, Këshilli konfirmoi zotimin ndaj agjendës së Selanikut dhe ftoi Komisionin që të shqyrtojë më tej mundësitë për promovimin e kontakteve ndërmjet njerëzve me Ballkanin Perëndimor.³ Më 28 janar 2008, Këshilli mirëpriti qëllimin e Komisionit për të filluar dialogun për viza me të gjitha vendet e rajonit dhe shprehu gatishmërinë e tij për ta shqyrtuar më tej këtë çështje, me synimin që të përcaktojë udhërrëfytes të hollësishëm duke caktuar standarde të qarta për t'u përmbushur nga të gjitha vendet e rajonit në mënyrë që gradualisht të përparojnë drejt liberalizimit të vizave.⁴ Më 7 dhe 8 dhjetor 2009, Këshilli theksoi se, pasi të përmbushen të gjitha kushtet, edhe Kosova duhet të përfitojë nga perspektiva e liberalizimit të mundshëm të vizave dhe ftoi Komisionin të lëvizë me një qasje të strukturuar për të sjellë qytetarët e Kosovës më afër BE-së.⁵

Më 14 dhjetor 2010, Këshilli konfirmoi se pas plotësimit të të gjitha kushteve Kosova do të përfitojë nga perspektiva e liberalizimit të mundshëm të vizave; vlerësoi progresin e arritur në fushën e ripranimit dhe riintegrit; dhe konsideroi qëllimin e Komisionit për të filluar dialogun për liberalizimin e vizave pas përmbushjes së të gjitha kushteve, dhe, qëllimin e Komisionit për ta komunikuar vlerësimin e tij para Këshillit lidhur me përmbushjen e kushteve të tilla, para fillimit të këtij dialogu⁶

Me 5 dhjetor 2011, Këshilli konfirmoi se Kosova do të përfitonte nga perspektiva e liberalizimit të mundshëm të vizave pas përmbushjes të të gjitha kushteve dhe pa paragjykim ndaj qëndrimit të shteteve anëtare rreth statusit.⁷ Duke pasur parasysh progresin e Kosovës për sa i përket ripranimit dhe riintegrit, Këshilli mirëpriti qëllimin e Komisionit të realizojë pikat në vijim:

1. Të fillojë dialogun për viza me Kosovën, pa paragjykim ndaj qëndrimit të shteteve anëtare për statusin, nëse të gjitha kushtet plotësohen në mënyrë efektive;
2. Të ndërlihdh në mënyrë të plotë Këshillin dhe shtetet anëtare në secilin hap të dialogut;

*Ky denominim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e GJND-së për deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

² Konkluzionet e Këshillit të datës 16/06/2003

³ Konkluzionet e Këshillit të datës 10/12/2007

⁴ Konkluzionet e Këshillit të datës 28/01/2008

⁵ Konkluzionet e Këshillit të 7-8/12/2009

⁶ Konkluzionet e Këshillit të 14/12/2010

⁷ Konkluzionet e Këshillit të 5/12/2011

3. Të paraqes raporte të rregullta mbi progresin e Kosovës në miratimin dhe zbatimin e reformave përkatëse, duke u bazuar edhe në raportet e ekspertëve të shteteve anëtare në terren.

Përfundimisht, Këshilli për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, me 13 dhjetor 2011 shqyrtoi gjendjen e progresit të Kosovës në fushën e ripranimit dhe riintegrimin.

- B. Komisioni gjithmonë ka insistuar që të ketë progres të kënaqshëm në fushën e ripranimit dhe riintegrimin, si elemente të domosdoshme që duhet të arrihen para fillimit të dialogut për liberalizimin e vizave me Kosovën. Me zbatimin e reformave në vitin 2011, Kosova ka arritur progres të kënaqshëm në vendosjen e një kornize funksionale të politikave për riintegrimin e të kthyerve në Kosovë, sikurse ka bërë tashmë në rastin e ripranimit.

Komisioni do të vazhdojë të monitorojë dhe vlerësojë, nëpërmes raporteve të rregullta, progresin e Kosovës në zhvillimin e kornizës së ripranimit dhe riintegrimin efektiv të të kthyerve.

Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, dhe, duke pasur parasysh kërkesat/kushtet e Këshillit të shprehura nëpërmes konkluzioneve të ndryshme të tij, e, po ashtu, si rezultat e një numri të misioneve të ekspertëve dhe takimeve të mbajtura gjatë viteve të fundit për të verifikuar përmbushjen e kushteve lidhur me ripranimin dhe riintegrimin e të kthyerve, më 19 janar 2012 Komisioni filloi dialogun për viza me Kosovën.

- C. Në kuadër të dialogut për viza, Kosovës i kërkohet që fillimisht të miratojë ose ndryshojë legjislacionin e përcaktuar në këtë udhërrëfyes në pajtueshmëri me *acquis* e BE-së. Kosova pastaj duhet të zbatojë plotësisht këtë legjislacion dhe të gjitha masat tjera të specifikuar në këtë dokument.

Konsultim i përforcuar

Komisioni do të përfshijë në mënyrë të plotë Këshillin dhe shtetet anëtare në secilin hap të dialogut nëpërmes konsultimit të përforcuar. Kjo do të përfshijë si në vijim:

1. Përfshirjen e plotë të Këshillit dhe shteteve anëtare në zhvillimin dhe, nëse është nevoja, ndryshimin e këtij udhërrëfyesi;
2. Pjesëmarrjen e plotë të ekspertëve të shteteve anëtare në vlerësimin e progresit të Kosovës në përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes;
3. Shfrytëzimin ekspertizës së EUROPOL-it, EUROJUST-it, FRONTEX-it, EASO-s, si dhe EULEX-it, në vlerësimin e progresit të Kosovës në përmbushjen e këtyre kushteve.

Monitorimi dhe raportimi

Komisioni do të prezantojë raporte të rregullta para Këshillit dhe shteteve anëtare, si dhe Parlamentit Evropian, duke paraqitur në hollësi vlerësimin e përmbushjes nga Kosova të parakushteve të parapara me këtë udhërrëfyes. Këto raporte do të adresojnë parakushtet e ndërlydhura me ripranimin dhe riintegrimin (Seksioni I) dhe blloqe të ndryshme të dialogut të vizave (Seksioni II).

Këto raporte do të bazohen në këto burime: informatat e siguruara nga Kosova; misionet vlerësuese të ndërmarra nga ekspertët e Komisionit dhe shteteve anëtare për vlerësimin e progresit të Kosovës në blloqe të ndryshme të dialogut për viza; si dhe, të dhënat e ofruara nga EUROPOL, EUROJUST, FRONTEX, EASO, dhe EULEX.

Raportet e rregullta të Komisionit do të vlerësojnë aspektet në vijim:

1. Arritjet e Kosovës në miratimin ose ndryshimin e legjislacionit në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së, të përcaktuar në këtë udhërrëfyes;
2. Arritjet e Kosovës në zbatimin e legjislacionit dhe të gjitha masave tjera të vendosura në këtë udhërrëfyes, dhe
3. Ndikimet e pritura migruese dhe të sigurisë nga liberalizimi i regjimit të vizave më Kosovën.⁸

Në bazë të këtyre raporteve të rregullta dhe dokumentet e punës të stafit të Komisionit për monitorimin e post-liberalizimit të vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor, Këshilli për Drejtësi dhe Punë të Brendshme mund të shqyrtojë mbajtjen e diskutimeve, në fund të secilit gjashtëmuor, lidhur me progresin e këtij dialogu. Komisioni do t'i merr me konsideratë të lartë konkluzionet politike të diskutimeve në Këshill.

Diskutimet në Këshill do të adresojnë aspektet në vijim:

1. Arritjet e Kosovës në miratimin ose ndryshimin e legjislacionit të përcaktuar në këtë udhërrëfyes në harmoni me *acquis* të BE-së;
2. Arritjet e Kosovës në zbatimin e legjislacionit dhe të gjitha masave tjera të vendosura në këtë udhërrëfyes; dhe
3. Ndikimet e pritura migruese dhe të sigurisë të liberalizimit të regjimit të vizave me Kosovën.

Komisioni gjithashtu do të informojë Parlamentin Evropian, së paku një herë në vit, lidhur me progresin e dialogut për viza.

Qëndrimi mbi statusin

⁸ Komisioni do të vazhdoj të monitorojë dhe raportojë para Këshillit dhe shteteve anëtare, si dhe Parlamentit Evropian, mbi arritjet e Kosovës në miratimin dhe zbatimin e masave dhe përmbushjes së kushteve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes, duke marr parasysh ndër të tjera, një numër të treguesve të performancës të specifikuar në dispozitat përfundimtare

Dialogu për viza do të drejtohet pa paragjykim ndaj qëndrimit të shteteve anëtare për statusin. Kosova duhet të bëjë përpjekje të përmbush kushtet e përcaktuara me këtë udhërrëfyes në lidhje me të gjitha shtetet anëtare. Në rastet ku është e nevojshme dhe/ose e aplikueshme, Kosova duhet të shfrytëzoj kanalet e duhura.

D. Elementet në vijim duhet të merren parasysh me rastin e vendosjes së metodologjisë për procesin e liberalizimit të vizave me Kosovën:

- Perspektiva Evropiane e Ballkanit Perëndimor, pjesë e së cilës është edhe Kosova
- Zotimi politik i dhënë nga Bashkimi Evropian, si pjesë e agjendës së Selanikut, për të liberalizuar regjimin afatshkurtër të vizave për Ballkanin Perëndimor, që është konfirmuar në nivelet politike nga një numër i konkluzioneve të Këshillit që nga viti 2003;
- Konfirmimi i Këshillit se Kosova gjithashtu do të përfitojë nga perspektiva e liberalizimit të mundshëm të vizave, pas përmbushjes të të gjitha kushteve dhe pa paragjykim ndaj qëndrimit të shteteve anëtare për statusin;
- Mundësia që qytetarët e BE-së të udhëtojnë në Kosovë pa viza.

E. Duke pasur parasysh gamën e gjerë të çështjeve që janë të ndërlidhura me liberalizimin e vizave dhe nevojën për krijimin e një konteksti të sigurt në mënyrë adekuate për udhëtim pa viza, ky udhërrëfyes ka për qëllim të identifikojë legjislacionin dhe të gjitha masat tjera që Kosova duhet t'i miratojë dhe zbatojë, si dhe, kushtet që duhet të përmbushen në periudhën afatshkurtër për avancimin drejt liberalizimit të vizave. Dialogu për liberalizimin e vizave do të adresojë katër grupe të çështjeve, si: siguria e dokumenteve; menaxhimi i kufirit/kufirit administrativ dhe migracionit; siguria dhe rendi publik; dhe të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes. Ky dialog do të përshtatet për t'i mundësuar Kosovës të fokusojë përpjekjet për reforma dhe të plotësojë parakushtet e BE-së. Shpejtësia e lëvizjes drejt liberalizimit të vizave do të varet nga arritjet e Kosovës në miratimin dhe zbatimin e masave dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes.

Dialogu për liberalizimin e vizave, si pjesë e politikës së përgjithshme të BE-së për Ballkanin Perëndimor, do të realizohet në kuadër të Dialogut për Procesin e Stabilizim-Asociimit. Kjo do të kryhet nga zyrtarë të lartë të cilët mund të vendosin për organizimin e takimeve teknike të nivelit të ekspertëve për çështje specifike. Progresi i arritur për çështjet e mbuluara nga dialogu për liberalizimin e vizave do të raportohet në kuadër të Dialogut për Procesin e Stabilizim-Asociimit.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) në pajtim me mandatin që ka⁹, do të ketë një rol të rëndësishëm në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin

⁹ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i ndryshuar nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2009/445/CFSP dhe Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2010/322/CFSP.

e institucioneve të Kosovës për miratimin dhe zbatimin e reformave dhe përmbushjen e kërkesave të caktuara në këtë udhërrëfyes. Bashkëpunimi efektiv i autoriteteve të Kosovës me EULEX-in, përfshirë edhe përmbushja e mandatit të tij ekzekutiv, do të jetë thelbësor.

- F. Me përmbushjen e të gjitha kushteve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes, Komisioni do të paraqes një propozim para Parlamentit Evropian dhe Këshillit për heqjen e obligimit për viza për qytetarët e Kosovës, përmes një plotësim-ndryshimi të Rregullores së Këshillit (EC) 539/2001. Pa paragjykim ndaj qëndrimeve të shteteve anëtare për statusin në kohën e propozimit, Komisioni mund të shqyrtojë propozimin për të transferuar Kosovën nga Pjesa 2 e Aneksit I në pjesën e përkatëse të Aneksit II të kësaj Rregulloreje. Ky propozim do të mbulojë vetëm bartësit e dokumenteve biometrike të udhëtimit. Në pajtim me nenin 77(2)(a) të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli vendosin në pajtim me procedurat e zakonshme legislative.

UDHËRRËFYESI DREJT NJË REGJIMI PA VIZA ME KOSOVËN

I. Kushtet lidhur me ripranimin dhe riintegrimin

Ripranimi

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të vazhdojë zbatimin e legjislacionit vendor për fushën e ripranimit;
- Të vazhdojë zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për ripranim dhe, sipas nevojës, të nënshkruajë marrëveshje të reja për ripranim;
- Të sigurojë procedura të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe kthimin e qytetarëve të Kosovës, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të cilët nuk i plotësojnë, ose nuk i plotësojnë tash e tutje kushtet për hyrje, prezencë, ose qëndrim në territoret e një nga shteteve anëtare dhe të lehtësojë kalimin/transitin e personave në frymë të bashkëpunimit;
- Të sigurojë që procedurat e ripranimit, të kryera përmes kanaleve përkatëse, funksionojnë në lidhje me të gjitha shtetet anëtare;
- Të fuqizojë kapacitetet e autoriteteve kompetente për procedimin e aplikacioneve për ripranim dhe të ulët numri i kërkesave të pazgjidhura për ripranim;
- Të sigurojë që aplikacionet për ripranim të procedohen në pajtim me rregullat vendore për mbrojtje të të dhënave;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për ripranim tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.

Riintegrimi

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të miratojë dhe zbatojë masat për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të autoriteteve kompetente për riintegrim, procedurat për aplikim dhe vendimmarrje dhe të drejtat dhe obligimet e përfituesve në kuadër të programit të riintegrit;
- Të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për riintegrim, me theks të veçantë mbi raportimin dhe monitorimin, disbursimin dhe decentralizimin e Fondit të Riintegrit; dhe shtimin e qasjes së të kthyerve, posaçërisht atyre nga minoritetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas në punësim, trajnime profesionale dhe edukim.
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për riintegrimin e të kthyerve, te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it.

II. Kushtet lidhur me sigurinë e dokumenteve; menaxhimin e kufirit/kufirit administrativ; rendit dhe sigurisë publike; dhe të drejtat themelore për sa i përket lirisë së lëvizjes

BLLOKU 1: Siguria e dokumenteve

Dokumentet personale të udhëtimit, letërnjoftimet dhe dokumentet sekondare

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të lëshojë dokumente personale biometrike të udhëtimit të lexueshme nga makina (kompjuteri) në pajtueshmëri me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC) dhe standardet e BE-së për shenjat e sigurisë dhe të dhënat biometrike në dokumentet e udhëtimit¹⁰ dhe të bëhen përpjekje për të gjetur mënyra të mundshme të bashkëpunimit, nëpërmes kanaleve përkatëse, me platformën e njohur si Public Key Infrastructure të ONAC-ut, ;
- Të miratojë dhe zbatojë masa për garantimin e integritetit dhe sigurisë të procesit të gjendjes civile dhe regjistrimit civil, duke përfshirë edhe integrimin dhe lidhjen e bazave të të dhënave përkatëse dhe verifikimin e të dhënave të skanuara kundrejt bazës së të dhënave të gjendjes civile, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndryshimit të të dhënave personale themelore të individëve;

¹⁰ Rregullorja mbi standardet për shenjat e sigurisë dhe të dhënat biometrike në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga vendet anëtare (Rregullorja 2252/2004 të ndryshuar me Rregulloren 444/2009)

- Të miratojë dhe zbatojë masa që garantojnë integritetin dhe sigurinë e procesit të aplikimit për dokumente, lëshimit dhe shpërndarjes, posaçërisht sa i përket dokumenteve personale të udhëtimit dhe letërnjoftimit, duke përfshirë letërnjoftimet biometrike;
- Të miratojë dhe zbatojë masa që garantojnë integritetin dhe sigurinë e dokumenteve sekondare, posaçërisht certifikatave të gjendjes civile, dhe letërnjoftimeve, duke përfshirë letërnjoftimet biometrike; përcaktimi dhe zbatimi i procedurave strikte për lëshimin e tyre;
- Të raportojë nëpërmes kanaleve përkatëse në bazën e të dhënave të Interpolit LASP, lidhur me dokumentet personale të udhëtimit të vjedhura ose të humbura;
- Të fuqizojë kapacitetet e agjencisë së regjistrimit civil për kryerjen e detyrave të saj;
- Të mbajë programe trajnuese lidhur me kundër korrupsionin dhe vendosjen e një kodi të etikës për zyrtarët e përfshirë në procesin e regjistrimit civil, aplikimit për dokumente dhe shpërndarjes;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme mbi numrin e lëshuar të dokumenteve personale të udhëtimit dhe letërnjoftimeve, përfshirë letërnjoftimet tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it

BLLOKU 2: Menaxhimi i Kufirit/kufirit administrative dhe migracionit

Menaxhimi i kufirit/kufirit administrativ

Në bashkëpunim me EULEX-in dhe KFOR-in, Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të harmonizojë me *acquis* të BE-së¹¹ dhe të zbatojë legjislacionin mbi menaxhimin e integruar të kufirit/kufirit administrativ (MIK), përfshirë dispozitat e reja ligjore lidhur me bashkëpunimin ndër-institucional ndërmjet autoriteteve kompetente të përfshira në MIK;
- Të zbatojë marrëveshjet ekzistuese bilaterale në fushën e menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ, dhe nëse është e nevojshme, të nënshkruaj marrëveshje të reja për menaxhimin e kufirit/kufirit administrativ;
- Të zbatojë në mënyrë të koordinuar me palën tjetër, Protokollin Teknik për zbatimin e konkluzioneve të arritura për MIK të dialogut të 2 dhjetorit 2011;

¹¹ Posaçërisht Kodin për Kufijtë e Shengenit (Rregullorja 562/2006), Rregullorja për Frontex-in (Rregullorja 2007/2004, e ndryshuar me Rregulloren 1168/2011), Rregullorja për Trafikun lokal të kufirit (Rregullorja 1931/2006), Rregullorja VIS (Rregullorja 767/2002), dhe Kodi i Komunitetit për Viza (Rregullorja 810/2009)

- Të bëjë përpjekje për përfundimin e demarkacionit të kufirit/kufirit administrativ me Malin e Zi, në mënyrë të koordinuar me palën tjetër;
- Të miratojë dhe zbatojë strategjinë e re për MIK dhe planin e veprimit;¹²
- Të përmirësojë kontrollin e kufirit/kufirit administrativ (ndalimet dhe vëzhgimet) në dhe ndërmjet pikave të kalimit të kufirit/kufirit administrativ, me theks të veçantë nëpërmes rritjes së analizës së rreziqeve dhe inteligjencës kriminale, për të siguruar kontrollin e një personi, veturave dhe mallrave që kalojnë kufirin/kufirin administrativ dhe vëzhgim efektiv ndërmjet të gjitha pikave kufitare/kufirit administrativ;
- Aty ku është e mundur, të ndërtohen pika të përbashkëta të kalimit të kufirit/kufirit administrativ për kontroll dhe vëzhgim të koordinuar të personave, veturave dhe mallrave që kalojnë kufirin/kufirin administrativ, përfshirë përmes njësive statike dhe mobile dhe operacioneve të koordinuara të monitorimit dhe patrullimit;
- Të rritet parandalimi, zbulimi dhe hetimi i krimeve të rënda ndërkufitare, posaçërisht trafikimi i qenieve njerëzore, lehtësimi i migracionit të parregullt, trafikimi i narkotikëve dhe prekursorëve, trafikimit i armëve dhe krimeve të kryera nga grupe endacake kriminale, përmes shkëmbimit të informacioneve të nevojshme strategjike dhe operative dhe inteligjencës kriminale me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, në pajtim me rregullat vendore të mbrojtjes së të dhënave dhe përmes kanaleve përkatëse;
- Të fuqizohen kapacitetet e qendrës koordinuese vendore për koordinimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet autoriteteve vendore të përfshira në MIK, duke përfshirë vëzhgimin e kufirit;
- Në bazë të dispozitave të reja ligjore, të shtojë bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në MIK dhe të fuqizojë kapacitetet e tyre për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive dhe të pavarur;
- Në pajtim me rregullat vendore për mbrojtjen e të dhënave personale, të përmirësojë qasjen e të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në MIK në sistemin ekzistues të menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ dhe të dhënat e proceduara nga qendrat nacionale koordinuese;
- Të mbajë e programe trajnuese në fushën e kundër korrupsionit dhe luftimit të kriminit të organizuar dhe të vendosë një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në MIK;

¹² Kjo duhet të jetë në pajtim me konceptin BE-së për MIK, sikurse është përcaktuar me Konkluzionet e Këshillit të 4-5 dhjetorit 2006 dhe më tutje të shpjeguar në Katalogun e Shengenit për Kontrollit e Kufirit të Jashtëm, Kthimin dhe Ripranimin

- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme lidhur me masat e kontrollit të kufirit/kufirit administrativ, duke përfshirë numrin e koordinuar të monitorimit dhe operacioneve patrulluese, tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it;
- Të hulumtojë modalitetet e bashkëpunimit me FRONTEX.

Përgjegjësitë e transportuesve

Kosova duhet t'i përmbushë këto kushte:

- Të miratojë dhe zbatojë masa që përcaktojnë përgjegjësitë ligjore të transportuesve, përfshirë dënimet financiare, për kthimin e shtetasve të vendeve të treta të cilët nuk i plotësojnë kushtet për hyrje në Kosovë.

Menaxhimi i migracionit

Kosova duhet të përmbushë këto kushte:

- Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për migracionin legal në pajtueshmëri me *acquis* e BE-së;¹³
- Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin mbi migracionin e parregullt në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së¹⁴
- Të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për migracion; të bëjë rishikimin e këtyre dokumenteve, nëse është e nevojshme të sigurohet veprim efektiv; dhe të caktohen tregues të qartë për matjen e performancës në këtë fushë;
- Të zhvillojë bazën e të dhënave për migracion dhe të sigurojë qasje për të gjitha autoritetet e përfshira në menaxhimin e migracionit, në pajtim me rregullat vendore të mbrojtjes së të dhënave;
- Të krijojë dhe aplikojë një mekanizëm për monitorimin e lëvizjeve së migracionit; të përcaktojë një profil të rregullt-të përditësuar të migracionit për Kosovën, me të dhëna lidhur me migracionin legal dhe të parregullt; dhe, të krijojë një autoritet publik përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin dhe lëvizjet e migracionit;

¹³ Posaçërisht Direktive Leje Unike (Direktiva 2011/98/EU), Direktiva mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për studime dhe trajnime (Direktiva 2004/114/EC), Direktiva për pranimin e shtetasve të vendeve të treta për hulumtime (Direktiva 2005/71/EC), Direktiva mbi të drejtën e ribashkimit familjar (Direktiva 2003/86/EC), Direktiva për rezidentët afatgjatë (Direktiva 2003/109/EC), dhe Direktiva për Kartelën Blu (Direktiva 2009/50/EC).

¹⁴ Posaçërisht Direktiva për Kthim (Direktiva 2008/115/EC), Direktiva për asistencën në rast të largimit ajror (Direktiva 2003/110/EC), dhe Direktiva për sigurimin e standardeve minimale për sanksionet kundër punëdhënësve të shtetasve të vendeve të treta me qëndrim ilegal (Direktiva 2009/52/EC)

- Të definojë dhe aplikojë një metodologji për zbulime brenda vendit dhe përmirësoj kapacitetet e autoriteteve kompetente në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe lehtësimin e migracionit të parregullt;
- Të vendosë një procedurë të përshtatshme për dëbimin dhe largimin efektiv nga Kosova të shtetasve të vendeve të treta me qëndrim ilegal;
- Të mbaj programeve trajnuese lidhur me kundër-korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në politikat e migracionit;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për ofrimin dhe lëvizjet e migracionit legal dhe të parregullt te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it;
- Të shqyrtojë mënyrat e bashkëpunimit me iniciativat rajonale për migracionin, azilin dhe refugjatët.

Azili

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të harmonizojë me *acquis* të BE-së¹⁵ dhe të zbatojë legjislacionin mbi azilin;
- Të fuqizojë kapacitetet e autoriteteve kompetente në përmbushjen e detyrave të tyre, në veçanti sa i përket kushteve të pranimit dhe procedurave të azilit;
- Të përmirësojë kushtet ekzistuese materiale, dokumentacionin dhe shërbimet tjera publike në dispozicion për azilkërkues, duke përfshirë personat me nevoja të veçanta;
- Të garantojë pavarësinë dhe ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve mbikëqyrëse të ngarkuara me azilin;
- Të mbaj programeve të trajnimit lidhur me kundër korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në politikat e azilit;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për azilin te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it;
- Të shqyrtojë modalitetet e bashkëpunimit me EASO.

¹⁵ posaçërisht Direktiva mbi kushtet e pranimit për azilkërkuesit (Direktiva 2003/9/EC), Direktiva e Kualifikimit (Direktiva 2004/83/EC dhe Direktiva Recast për standardet e kualifikimit e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kanë të drejtë për mbështetje shtesë dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së ofruar (2011/95/EU) dhe Direktiva për Procedurat e Azilit (Direktiva 2005/85/EC)

BLLOKU 3: Siguria dhe rendi publik

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë shpëlarjen e parave, dhe krimit financiar, konfiskimin dhe kthimin e aseteve, si dhe financimin e terrorizmit, në pajtim me *acquis* të BE-së,¹⁶ duke siguruar se ndryshimet në këtë legjislacion po ashtu janë reflektuar në kodin penal;
- Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, në pajtim me *acquis* të BE-së;¹⁷ të sigurojë hetimin dhe ndjekjen proaktive e trafikimit me qenie njerëzore, duke përfshirë dënimet bindëse për individët që janë shpallur fajtorë në këtë krim serioz; të shtojë efikasitetin e identifikimit të viktimave;
- Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit më narkotikë dhe prekursorë, në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së;¹⁸ të sigurojë hetimin dhe ndjekjen proaktive të këtyre krimeve;
- Të zbatojë strategjitë dhe planet e veprimit për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me droga dhe prekursorë, kundër terrorizmit, parandalimit të krimit dhe trafikimit me armë; të rishikojë këto dokumente, nëse është e nevojshme të përcaktojë veprime efektive; dhe të vendos tregues të qartë për matjen e performancës në këto fusha;

¹⁶ Posaçërisht Vendimi Kornizë për luftimin e krimit të organizuar (Vendimi Kornizë 2008/841/JHA), Direktiva e tretë kundër shpëlarjes së parave (Direktiva 2005/60/EC dhe 2006/70/EC), Vendimet Kornizë dhe Vendimet e Këshillit mbi ngriren dhe konfiskimin e profitit nga krimi (Vendimet Kornizë 2001/500/JHA, 2003/577/JHA, 2005/212/JHA, 2006/783/JHA, dhe Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA), Vendimi i Këshillit mbi Bashkëpunimin të Njësive për Inteligjencë Financiare (Vendimi 2000/783/JHA), Vendimi Kornizë për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve që nuk përfshijnë pagesa me para të gatshme (Vendimi Kornizë 2001/413/JHA), Vendimi Kornizë për vendosjen e sanksioneve penale kundër falsifikimit të euro-së (Vendimi Kornizë 2000/383/JHA, i ndryshuar me Vendimin Kornizë 2001/888/JHA) dhe Vendimi i Këshillit për mbrojtjen e euro-së kundër falsifikimit (Vendimi 2001/887/JHA), Vendimi i Këshillit për Zyrat për Kthimin e Aseteve (Vendimi 2007/845/JHA), dhe Vendimi Kornizë mbi korrupsionin në sektorin privat (Vendimi Kornizë 2003/568/JHA).

¹⁷ Posaçërisht Direktiva për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore (Direktiva 2001/36/EC), Deklarata e Brukselit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore (Konkluzionet e Këshillit të 8 majit 2003) dhe Direktiva për luftimin abuzimin seksual dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve (Direktiva 2011/93/EU).

¹⁸ Posaçërisht Strategjia e BE-së për Droga 2005-2012, Pakti Evropian për luftimin e trafikimit ndërkombëtar të drogës – pengimi i rrugëve të kokainës dhe heroinës (miratuar më 3 qershor 2011), Vendimi Kornizë mbi dispozitat dhe dënimet minimale në fushën e trafikimit ilegal të narkotikëve (Vendimi Kornizë 2004/757/JHA), Vendimi i Këshillit për shkëmbimin e informatave lidhur me substancat e reja psikotropike (Vendimi 2005/387/JHA) dhe Rregullorja mbi rregullat për monitorimin e tregtisë me prekursor të drogës

- Të realizojë hetime proaktive të pasurisë së pazakonshme/të dyshimtë; të vendos një sistem të mirë kundër shpëlarjes së parave; dhe të zhvillojë dhe zbatojë një sistem solid për konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve;
- Të fuqizojë kapacitetet e policisë dhe njësisë përgjegjëse për inteligjencë financiare për të kryer në mënyrë efektive dhe të pavarur hetime komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë shpëlarjen e parave dhe krimeve ekonomike dhe financiare;
- Të fuqizojë kapacitetet e policisë për zbulim dhe hetim, prokurorëve për ndjekje dhe gjyqtarëve për gjykim, në mënyrë të pavarur, të rasteve komplekse të krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ekonomik dhe financiar dhe terrorizmit; të zhvillojë historik/regjistër të hetimeve dhe aktgjykimeve finale të gjykatave lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë trafikimin me narkotikë, trafikimin me qenie njerëzore dhe shpëlarje të parave;
- Të përmirësojë koordinimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave dhe inteligjencës kriminale ndërmjet autoriteteve për zbatim të ligjit dhe atyre gjyqësore, posaçërisht policisë dhe prokurorisë, për të përmirësuar arritjet e Kosovës në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve ekonomike dhe financiare, dhe terrorizmit;
- Të zbatojë legjislacionin ekzistues për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të fuqizojë kapacitetet policisë për krijimin dhe funksionalizimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve;
- Të zhvillojë një bazë të qëndrueshme të të dhënave për regjistrin e veprave penale, përfshirë në baza të asistencës reciproke ligjore për çështje penale;
- Të garantojë zbatim efektiv dhe efikas të vendimeve të gjykatave;
- Të vendos mekanizma efektivë për parandalimin e korrupsionit dhe për identifikimin dhe përcjelljen e rrezikut për korrupsion, duke përfshirë vlerësimet e rreziqeve në sektor më të ndjeshëm; të garantohet transparencë, integriteti dhe llogaridhënia e zyrtarëve të administratës publike dhe zyrtarëve të zgjedhur, zbulimin dhe heqjen e konflikteve të interesit, verifikimin e pasurisë së zyrtarëve publik dhe transparencën e financimit të partive politike;
- Të shtojë efikasitetin e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Të mbaj programe trajnuese për kundër korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe të vendoset një kod i etikës për zyrtarët publik të përfshirë në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar, korrupsionit dhe

terrorizmit te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it

Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të zbatojë marrëveshjet ekzistuese për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit, dhe ku është e mundshme të nënshkruaj marrëveshje të reja;
- Aty ku është e mundshme, të vendos zyrtarë ndërlidhës për zbatim të ligjit në shtetet anëtare dhe vende të treta;
- Të rris nivelin e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda ndërkufitare, me theks të veçantë të trafikimit me qenie njerëzore, lehtësimin të migracionit të parregullt, trafikimit me narkotikë dhe prekursorë, trafikimin me armë dhe krime të kryera nga grupe endacake kriminale, nëpërmes shkëmbimit me autoritetet kompetente të sundimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, në pajtueshmëri me rregullat vendore të mbrojtjes së të dhënave dhe nëpërmes kanaleve përkatëse, informatave të nevojshme strategjike dhe operative, dhe inteligjencës kriminale;
- Të vendos një aranzhim me EULEX-in për shkëmbim të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të informatave strategjike dhe operative dhe inteligjencë kriminale të nevojshme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda; të zbatojë marrëveshjet ekzistuese me EULEX-in lidhur me shkëmbimin e të dhënave për çështje tatimore dhe doganore;
- Të garantojë se shkëmbimi i informatave për zbatim të ligjit, i kryer nëpërmes kanaleve përkatëse, funksionon në lidhje më te gjitha shtetet anëtare;
- Të shtojë bashkëpunimi operacional me autoritetet e sundimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, me theks të veçantë me anë të realizimit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta;
- Të përmirësojë kapacitetet hetuese të udhëhequra nga inteligjenca, të autoriteteve për sundim të ligjit për hetimin e krimeve të rënda ndërkufitare/kufirit administrativ;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme lidhur me shkëmbimin e informatave në fushën e zbatimit të ligjit, hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it;
- Të shqyrtojë mundësitë për bashkëpunim me EUROPOL
- Të shqyrtojë mënyrat e bashkëpunimit me EMCDDA;

- Të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me iniciativat rajonale për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit.

Bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale

Kosova duhet t'i përmbushë këto kushte:

- Të zbatojë legjislacionin ekzistues për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale;
- Të zbatojë marrëveshjet ekzistuese për bashkëpunim në çështje penale dhe ku është e mundshme të nënshkruaj marrëveshje të reja;
- Të miratojë dhe zbatojë masa që kanë për qëllim përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe pavarësisë së bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale me shtetet anëtare dhe vendet e treta;
- Të zbatojë marrëveshjen teknike me EULEX-in për ndihmë juridike reciproke;
- Të sigurojë se bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale, i realizuar nëpërmes kanaleve përkatëse, funksionon në lidhje me të gjitha shtetet anëtare;
- Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për rastet e bashkëpunimit juridik në çështje penale te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it;
- Të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me EUROJUST.

Mbrojtja e të dhënave

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të harmonizojë me *acquis* të BE-së¹⁹ dhe të zbatojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Të garantojë pavarësinë dhe të fuqizojë kapacitetet e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave;
- Të mbaj programe trajnuese lidhur me kundër korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale.

BLLOKU 4: Të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes

¹⁹ Posaçërisht Direktiva për Mbrojtjen e të dhënave personale (Direktiva 95/46/EC) dhe Vendimi Kornizë për procesimin e të dhënave personale në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështje penale (Vendimi Kornizë 2008/977/JHA)

Liria e lëvizjes

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të sigurojë që liria e lëvizjes e qytetarëve të Kosovës nuk i nënshtrohet kufizimeve të paarsyeshme, duke përfshirë edhe masat e natyrës diskriminuese, të bazuar në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra, etnia ose origjina sociale, tipare gjenetike, gjuha, besimi ose religjioni, mendimi politik ose ndonjë mendim tjetër, përkatësia e një grupi minoritar, lindja, aftësitë e kufizuara, mosha ose orientimi seksual.

Kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve identifikuese

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të sigurojë se të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë femrat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin një minoriteti dhe individëve të cenueshëm kanë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet personale të udhëtimit dhe identifikuese, përfshirë regjistrimin civil.
- Të sigurojë qasje të plotë dhe efektive në dokumente personale të udhëtimit dhe dokumente identifikuese për personat e zhvendosur, refugjatët dhe të kthyerit.

Të drejtat e njeriut dhe respekti dhe mbrojtja e minoriteteve

Kosova duhet t'i përmbush këto kushte:

- Të sigurojë se të gjitha dispozitat vendore për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve respektohen plotësisht;
- Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin që përcakton mbrojtje efektive kundër diskriminimit;
- Të sigurojë se legjislacioni relevant për përcaktimin e kushteve dhe rrethanave të marrjes së shtetësisë së Kosovës zbatohet në mënyrë të kënaqshme;
- Të sigurojë që incidentet e motivuara etnikisht të kryera në fushën e lëvizjes së lirë, duke përfshirë ato incidente që kanë për qëllim persona me përkatësi nga minoritetet, do të hetohen plotësisht;
- Të miratojë dhe zbatojë masat drejt shtimit të integritetit efektiv të personave që i takojnë minoritetit serb, rom, ashkali, egjiptas, boshnjak, turk, dhe goran të Kosovës.

Vërejtjet përfundimtare

Udhërrëfyesi i paraqitur përfshin një listë reformash për t'u miratuar dhe zbatuar nga Kosova në mënyrë që të hiqet obligimi për viza. Këto reforma janë të nevojshme për të garantuar lëvizjen e lirë në një mënyrë të sigurt dhe të parashikueshme dhe janë zhvilluar në bazë të informatave të disponueshme në kohën e hartimit. Me ndryshimin e substancial të gjendjes në Kosovë, Komisioni në konsultim të përforcuar me Këshillin dhe shtetet anëtare, mund të vendos të ndryshoj këtë udhërrëfyes.

Kosova duhet të ndërmerr fushata informuese të vazhdueshme dhe të targetuara me qëllim të qartësimit të të drejtave dhe obligimeve të udhëtimit pa viza, duke përfshirë informata rreth rregullave që rregullojnë qasjen në tregun e punës së BE-së dhe përgjegjësitë ligjore për shkeljen e të drejtave nën regjimin pa viza.

Komisioni do të vazhdoj të monitorojë dhe raportojë para Këshillit dhe shteteve anëtare, si dhe Parlamentit Evropian, mbi arritjet e Kosovës në miratimin dhe zbatimin e masave dhe përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes, duke marr parasysh ndër të tjera, këta tregues të performancës:

- Norma e refuzimit të vizave për aplikuesit nga Kosova;
- Norma e refuzimit të hytjes në zonën e përbashkët të Schengen-it për qytetarët e Kosovës;
- Numri i qytetarëve të Kosovës që janë zbuluar të kenë qëndruar ilegalisht në territorin e një prej shteteve anëtare;
- Numri i përgjithshëm i aplikacioneve për azil nga qytetarët e Kosovës; dhe
- Numri i refuzuar i aplikacioneve për ripranim i dorëzuar nga shtetet anëtare në Kosovë për qytetarët e Kosovës.

Një ulje substanciale në këta tregues të performancës përgjatë dialogut të vizave, do të shfrytëzohet si një referencë indikative në vlerësimet e Komisionit për ndikimet e pritura migratore dhe të sigurisë të liberalizimit të regjimit të vizave me Kosovën, duke përfshirë këtu edhe kohën kur Komisioni Evropian do të prezantojë propozimin legjislativ për heqjen e obligimit për viza për qytetarët e Kosovës. Kosova gjithashtu duhet të ndërmerr masat e nevojshme për të mundësuar zbatimin efikas të Veprimeve të Përbashkëta të BE-së për ndalime të udhëtimit.

Me përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara në këtë udhërrëfyes, Komisioni do të paraqes një propozim para Parlamentit Evropian dhe Këshillit për heqjen e obligimit të vizave për qytetarët e Kosovës përmes një plotësim-ndryshimi të Rregullores së Këshillit (EC) 539/2001. Pa paragjykim ndaj qëndrimeve të shteteve anëtare për statusin në kohën propozimi, Komisioni mund të konsideroj propozimin e transferimit të Kosovës nga Pjesa 2 e Aneksit I në pjesën përkatës të Aneksit II të kësaj Rregulloreje. Ky propozim do të mbuloj vetëm bartësit e dokumenteve biometrike të udhëtimit që janë lëshuar në pajtueshmëri me standardet e ONAC-ut dhe BE-së. Në pajtim me nenin 77(2)(a) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli duhet të vendosin sipas procedurave të zakonshme legislative.